



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Data	
Nr.	Prot.

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

KOMPENSIMIN FINANCIAR PASZGJEDHOR QË DO T'U SHPËRNDAHET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronjat “k” dhe “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kanë parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për administrimin e buxhetit të KQZ-së, sipas rregullave të fushës, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njuh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Neni 89, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, parashikon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, iu kompenson subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje, fondet me shumën që rezulton nga shumëzimi i votave të vlefshme të marra prej tyre me vlerën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 88, të Kodit Zgjedhor.

Vendimi nr. 27, datë 7.8.2023, i Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023”, përcakton subjektet zgjedhore që kanë përfituar jo më pak se 1 % të votave të vlefshme.

Vendimi nr. 727, datë 24.8.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023”, përcakton se vlera në para e një vote të vlefshme është 80.47 lekë.

Në bazë dhe për zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektakti “Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Qëllimi i këtij projektvendimi është kompensimi financiar paszgjedhor për ato subjekte zgjedhore, të cilat nuk kanë përfituar nga shpërndarja e fondeve, si paradhënie, partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023 dhe kanë

marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi, bazuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Lidhja nr. 2 e vendimit nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, përcakton se subjektet zgjedhore që kanë përfituar jo më pak se 1 % të votave të vlefshme, janë si më poshtë:

1. "Partia Socialiste e Shqipërisë" (PS)	579.625 vota	43.11%
2. "Bashkë Fitojmë" (BF)	247.883 vota	18.44%
3. "Partia Demokratike" (PDSH)	103.723 vota	7.71%
4. "Partia Socialdemokrate" (PSD)	86.283 vota	6.42%
5. "Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" (PAA)	44.047 vota	3.28%
6. "Partia Republikane Shqiptare" (PR)	32.071 vota	2.39%
7. "Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet" (PDIU)	28.978 vota	2.16%
8. "Partia Lëvizja e Legalitetit" (PLL)	23.683 vota	1.76%
9. "Aleanca Progresiste L.ZH.K" (LZHK)	22.906 vota	1.70%
10. "Partia Demokracia Sociale" (P.D.S)	21.798 vota	1.62%
11. "Fryma e Re Demokratike" (FRD)	18.459 vota	1.37%
12. "Aleanca Liberale e Djathtë" (ALD)	16.859 vota	1.25%
13. "Partia e Gjelbër" (P.GJ)	16.326 vota	1.21%

Gjithsej vota të vlefshme

1.242.641 vota

Vendimi nr. 30/2023 "Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2023", përcakton se fondi i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, ishte 100.000.000 (njëqind milion) lekë.

Referuar vendimit nr. 397, datë 22.4.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t'u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 maj 2023", Partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore që kanë përfituar fonde paradhënie të akorduara nga Buxheti i Shtetit në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, janë si më poshtë:

1. "Partia Demokratike" – 24.963.584,24 (njëzet e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër presje njëzet e katër) lekë.
2. "Partia Republikane" – 3.012.429,13 (tre milion e dymbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e nëntë presje trembëdhjetë) lekë.
3. "Aleanca Progresiste"-L.ZH.K – 1.100.255,80 (një milion e njëqind mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë presje tetëdhjetë) lekë.
4. "Partia Socialiste e Shqipërisë" – 42.833.466, 73 (dyzet e dy milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e tre) lekë.
5. "Partia e Lirisë" – 15.594.215,8 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë presje tetë) lekë.
6. "Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet" – 4.260.606,71 (katër milion e dyqind e gjashtë dhjetë mije e gjashtëqind e gjashtë presje shtatëdhjetë e një) lekë.

7. "Partia Fryma e Re Demokratike" – 1.194.064,75 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë e pesë) lekë.
8. "Partia Demokracia Sociale" – 1.123.779,90 (një milion e njëqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë) lekë.
9. "Partia Socialdemokrate" - 0 lekë.
10. "Bindja Demokratike" – 639.798,69 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.
11. "Partia e Gjelbër" – 797.915,09 (shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë presje nëntë) lekë.
12. "Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë" – 448.974,27 (katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër presje njëzet e shtatë) lekë.
13. "Aleanca Arbnore Kombëtare" – 532.820,88 (pesëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet presje tetëdhjetë e tetë) lekë.
14. "Partia Uniteti Kombëtar" – 562.618,08 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë presje tetë) lekë.

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, të cilat nuk kanë përfituar fonde paradhënie dhe kanë marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi, janë si më poshtë:

1. "Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" - 3.28%
2. "Partia Lëvizja e Legalitetit" – 1.76%
3. "Aleanca Liberale e Djathtë" – 1.25%

Për sa më sipër, si dhe referuar vendimit nr. 727, datë 24.8.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku përcaktohet se vlera në para e një vote të vlefshme është 80.47 lekë, shuma totale që përfiton si kompensim financiar paszgjedhor secili subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhje dhe nuk ka përfituar fonde paradhënie si ndihmë financiare për fushatën zgjedhore, por ka marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi, sipas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, është si më poshtë vijon::

- "Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" – $44.047 * 80.47 = 3.544.462$ lekë
- "Partia Lëvizja e Legalitetit" – $23.683 * 80.47 = 1.905.771$ lekë
- "Aleanca Liberale e Djathtë" – $16.859 * 80.47 = 1.356.644$ lekë

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi "Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t'u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023".

Valbona BALLGJINI -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA -Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**KOMPENSIMIN FINANCIAR PASZGJEDHOR QË DO T'U SHPËRNDARHET SUBJEKTEVE
ZGJEDHORE PJSËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “k” e “n”, dhe 2, nenit 89, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, si dhe vendimit nr. 727, datë 24.8.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”,

VËREJ:

Neni 89 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon kompensim financiar paszgjedhor për subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje, të cilat nuk kanë përfituar fonde sipas vendimit nr. 397, datë 22.4.2023, “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit që do t’u shpërndalet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka detyrimin t’u kompensojë fonde nga Buxheti i Shtetit atyre subjekteve zgjedhore të cilat kanë marrë jo më pak se 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023.

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u shpërndalet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”

Referuar vendimit nr. 397, datë 22.4.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”, partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore që kanë përfituar fonde paradhënie të akorduara nga Buxheti i Shtetit në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, janë si më poshtë:

1. “Partia Demokratike” – 24.963.584,24 (njëzet e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër presje njëzet e katër) lekë.
2. “Partia Republikane” – 3.012.429,13 (tre milion e dymbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e nëntë presje trembëdhjetë) lekë.
3. “Aleanca Progresiste”-L.ZH.K – 1.100.255,80 (një milion e njëqind mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë presje tetëdhjetë) lekë.
4. “Partia Socialiste e Shqipërisë” – 42.833.466, 73 (dyzet e dy milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e tre) lekë.
5. “Partia e Lirisë” – 15.594.215,8 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë presje tetë) lekë.
6. “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” – 4.260.606,71 (katër milion e dyqind e gjashtë dhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtë presje shtatëdhjetë e një) lekë.
7. “Partia Fryma e Re Demokratike” – 1.194.064,75 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë e pesë) lekë.
8. ‘Partia Demokracia Sociale” – 1.123.779,90 (një milion e njëqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë) lekë.
9. “Partia Socialdemokrate” –0 lekë.
10. “Bindja Demokratike” –639.798,69 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.
11. “Partia e Gjelbër”–797.915,09 (shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë presje nëntë) lekë.
12. “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”–448.974,27 (katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër presje njëzet e shtatë) lekë.
13. “Aleanca Arbnore Kombëtare”–532.820,88 (pesëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet presje tetëdhjetë e tetë) lekë.
14. “Partia Uniteti Kombëtar”-562.618,08 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë presje tetë) lekë.

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, të cilat nuk kanë përfituar fonde paradhënie dhe kanë marrë jo më pak se 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi, janë si më poshtë:

1. “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” - 3.28%
2. “Partia Lëvizja e Legalitetit”– 1.76%
3. “Aleanca Liberale e Djathtë” –1.25%

Numri i votave të vlefshme në shkallë vendi 1.242.641 (një milion e dyqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e dyzet e një) dhe vlera 1% e tyre përlllogarit:

$1.242.641 \cdot 0.01 = 12.426,41$ (dymbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë presje dyzet e një) vota.

Numri i votave të vlefshme takuese për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje e datës 14 Maj 2023, të cilat nuk përfituan fonde para zgjedhjeve është si më poshtë vijon:

- “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” – 44.047 (dyzet e katër mijë e dyzet e shtatë) vota.
- “Partia Lëvizja e Legalitetit” – 23.683 (njëzet e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) vota.
- “Aleanca Liberale e Djathtë” – 16.859 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) vota.

Referuar vendimit nr. 727, datë 24.8.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, partitë politike të cilat nuk përfituan fonde para zgjedhjeve dhe kanë marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi, janë si më poshtë vijon:

- “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” – $44.047 * 80.47 = 3.544.462$ lekë
- “Partia Lëvizja e Legalitetit” – $23.683 * 80.47 = 1.905.771$ lekë
- “Aleanca Liberale e Djathtë” – $16.859 * 80.47 = 1.356.644$ lekë

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronjat “k” e “n”, dhe 2, nenin 89 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 727, datë 24.8.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, si dhe vendimin nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”,

V E N D O S:

1. Të shpërndaj kompensimin financiar paszgjedhor për ato subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, të cilat kanë marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Lidhja nr. 1

Nr.	Emri i Partisë Politike	Fondi që përfitohet si kompensim financiar paszgjedhor (lekë)
1	“Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë” (PAA)	3.544.462
2	“Partia Lëvizja e Legalitetit” (PLL)	1.905.771
3	“Aleanca Liberale e Djathtë” (ALD)	1.356.644
TOTALI		6.806.877